



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 1304 prot.

Shkodër, më 15.04 .2024

V E N D I M

Nr. 111 , datë 15.04 .2024

"Për shtesë page për "Përgjegjës sektori" në NJAB të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; VKM Nr. 325, date 31.05.2023 , "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile /nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike" lidhja 3 pika 24; VKM Nr. 326, date 31.05.2023 , " Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore"; Udhëzimit të MFE Nr. 16, datë 16.06.2023, "Për mënyrën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile / nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike"; Bordi i Administrimit ne mbledhjen e saj te dates 15.04.2024,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtese page per "Pergjegjes sektori" ne NJAB znj.Ruskeda Berhani të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", sipas Udhëzimit të MFE Nr. 16, datë 16.06.2023 dhe rekomandimit të MFE-së, referuar VKM-s Nr. 325, date 31.05.2023 , "Për

miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile /nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike " lidhur me pika 24 " Në institucionet e përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësin në pozicionin "drejtor drejtorie" nëse funksioni i auditimit të brendshëm të institucionit është i organizuar në nivel drejtorie dhe për nëpunësin në pozicionin "përgjegjës sektori", nëse ky funksion është i organizuar në nivel sektori

2. Ky vendim shtrin efekti financiar nga data 01 prill 2023 e ne vazhdim
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Luigj Gurakuqi" për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Prof As. Dr. Adrian Leka

